



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT

KORÇË

VENDIM

Nr 75 Datë 15. 10. 2007

PËR

**PËR MIRATIM FONDI PREJ 250.000 LEKË PËR VENDOSJEN E
SISTEMIT TË HYRJES SË KONTROLLUAR TË HYRJES NË
BASHKI**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, për " PËR MIRATIM FONDI PREJ 250.000 LEKË PËR VENDOSJEN E SISTEMIT TË HYRJES SË KONTROLLUAR TË HYRJES NË BASHKI", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007". Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007". Udhëzimin nr 353 dt. 19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 250.000 lekë për Sistemin e hyrjes së kontrolluar në Bashki.

2. Ky fond do të përballohet nga fondi i kursyer i tenderit « Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007 » (fondi i N.S.H.P) me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet	00.	06260	05	Art. 6022008	- 250.000 lekë
Shtohet	00.	01110	05	Art. 2314320	+250.000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Personelit Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes si dhe Drejtoria e Informacionit në Bashki

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE